



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

REFERENCË:					
PËR/ZA/TO:	z.Ramush HARADINAJ, Kryeministër				
CC :	z. Behgjet PACOLLI, Zëvendës Kryeministër i parë znj. Albena RESHITAJ, Ministre e MMPH-së				
NGA/OD/FROM:	Fatmir Matoshi, Zëvendës Ministër i MMPH-së dhe				
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	RAPORT I PUNËS				
Nr. i zyrës:	1705	Lokacioni:	MMPH	Data:	20.04.2018
Br. kancelarije:		Kucni:		Datum:	
Room No.:		Extension:		Date:	
PËR MIRATIM/ZA USVAJANJE/FOR APPROVAL					<input checked="" type="checkbox"/>
PËR NËNSHKRIM/ZA POTPIS/FOR SIGNATURE					<input type="checkbox"/>
PËR KOMENTE/ZA KOMENTARE/FOR COMMENTS					<input type="checkbox"/>
A MUND TË DISKUTOJMË/DALI MOZEMO RASPRAVLJATI/MAY ËE DISCUSS					<input type="checkbox"/>
VËMENDJA JUAJ/VASA PAZNJA/YOUR ATTENTION					<input type="checkbox"/>
SIPAS DISKUTIMIT/KAKOJE RASPRAVLJENO/AS DISCUSSED					<input type="checkbox"/>
SIÇ ËSHTË KËRKUAR/KAKO JE ZATRAZENO/AS REQUESTED					<input checked="" type="checkbox"/>
SHËNIM DHE PËRGJIGJE/BELESKA I ODGOVOR/NOTE AND RETURN					<input type="checkbox"/>
PËR INFORMIMIN TUAJ/ZA VASU INFORMACIJU/FOR YOUR INFORMATION					<input checked="" type="checkbox"/>
AFATI/KRAJNI ROK/DEADLINE					

I nderuari Kryeministër Haradinaj, sipas kërkesës Tuaj, më poshtë po paraqes aktivitetet dhe punët kryesore të kryera që nga data e emërimit tim Zëvendës Ministër i MMPH-së më 3 tetor 2017.

- Me vendim të Ministres Reshitaj kam kryesur Grupin Punues për identifikimin e qështjeve rreth riorganizimit dhe plotësim ndryshimit të Rregullores 05/2017 për Organizimin e Brendshëm të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Ky grup me përbërjen e nive, lit më të lartë menagjues të MMPH-së, ka mbajtur takime të shumta si dhe punëtori të mbështetura edhe nga donatorët (GIZ-i), dhe ka hartuar draftin përfundimtar për ndryshim plotësimet në Rregulloren 05/2017.
- Kam udhëhequr bisedimet dhe takimet me Shoqatat dhe grupet e Gjeodetëve Agjencionin Kadastral të Kosovës dhe palët e tjera të interesit përsa i përket Ndryshimit të Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2013 i cili aktualisht u pamundëson Licencimin Gjeodetëve të Shkallës së Dytë. Ky udhëzim Administrativ pas këtyre bisedave është dorëzuar në shqyrtim ligjor dhe po presim opinionin ligjor rreth mundësisë së ndryshimit të tij.
- Kam mbajtur takime me grupin e deputeteve të Koalicionit VAKAT, rreth temës së Hidrocentraleve në Rajonin e Zhupës.
- 21- 23 dhjetor kam përfaqësuar Ministrinë në Konferencën për Menagjimin e integruar të resursve ujore (Lumit Drin) në një konferencë rajonale në Podgoricë – Mal të Zi.
- Së bashku me Ministren Reshitaj, kemi pasur vizitë zyrtare në Republikën e Shqipërisë dhe takime me Ministrin Blendi Klosi dhe Presidentin Ilir Meta.
- Kam vënë kontakte dhe kam mbajtur takimet e para me përfaqësuesit e Coca- Cola HBC, rreth mundësive për të mbështetur projekte që ndërlidhen me ambientin nga kjo kompani.
- Kam marrë pjesë në grupet punuese për përmirësimin e cilësisë së ajrit në Komunën e Prishtinës.
- Me autorizim të Ministres Reshitaj, kam mbajtur takimet dhe kam qenë bartës i procesit të sigurimit të dokumentacionit rreth zhvillimit të projektit për Prishtinën e Re – Qendrën Administrative në Hajvali.

- Në muajin mars 2018 e kam përfaqësuar MMPH-në në Konferencën ndërkombëtare për trajtimin e mbeturinave në Stamboll - Turqi (së bashku me zv. ministren Zdravkovic)
- Kam punuar në organizimin e takimit të Ministres Reshitaj me Kryetarët e Komunave të Republikës së Kosovës, për të diskutuar qështje dhe probleme që ndërlidhen në mes autoriteteve komunale dhe MMPH-së
- Jam angazhuar në përfundimin e punëve dhe ceremonisë së përrurimit të stacionit automatik hidrometeorologjik në Skivjan të Gjakovës.
- Takime të rregullta me Kryeshin e Agjencionit për Mbrojtjen e Mjedisit z. Ilir Morina

Takime të tjera me karakter pune

- Përfaqësuesit e GIZ-it
- Kryetarin e Prishtinës Shpend Ahmeti dhe Nënkryetarin Selim Pacolli së bashku me drejtorët
- Kryetarin e Hani i Elezit Rufki Suma
- Kryetarin e Gjilanit Lutfi Haziri
- Kryetarin e Novo Bërdës , Svetislav Ivanovic
- Kryetarin e Parteshit, Dragan Petkovic
- Kryetarin e Kamenicës, Qëndron Kastrati
- Ambasadorët e vendeve të ndryshme
- Organizata Joqeveritare

Me respekt ,